



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; 04 2268142

Nr. 1120/35 Akti

Tiranë, më 30.06.2017

V E N D I M

Nr.142, datë 30.06.2017

Mbi përfundimin e procedimit administrativ të nisur në kuadër të pretendimeve të ngritura nga Ministri i Arsimit dhe Sportit në takimet e Task Forcës, në lidhje me parregullsi në veprimtarinë dhe sjelljen e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në takimet e Task Forcës, të krijuar për koordinimin e procesit të monitorimit, sipas vendimit nr. 473, datë 1.6.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes, apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë, për vitin 2017", ku merrte pjesë si i ftuar, është njohur me pretendimet e ngritura nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, në lidhje me parregullsi në veprimtarinë dhe sjelljen e Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucionit.

Për këtë arsye, me aktin nr. 1120/28 prot., datë 19.06.2017 "Njoftim mbi fillimin e verifikimit", Komisioneri ngriti një grup pune për verifikimin e rastit në subjekt, si dhe i kërkoi Ministrit të Arsimit dhe Sportit që të vinte në dispozicion aktet administrative mbi të cilat mbështeteshin pretendimet në lidhje me veprimtarinë dhe sjelljen e parregullt të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit.

Për kryerjen e një hetimi të plotë administrativ të këtij rasti, duke vlerësuar rëndësinë e rastit, grupi i inspektimi u paraqit disa herë pranë institucionit, që prej datës së fillimit të procesit (19.06.2017) dhe vetëm në datën 21.06.2017, u arrit të realizohej një takim me anëtarët e Kabinetit të Ministrit.

(Paraqitja e grupit të inspektimit të KMSHC pranë MAS për kryerjen e verifikimeve të nevojshme dhe administrimin e dokumentacionit përkatës, është dokumentuar në procesverbalet e mbajtura në ambientet e MAS në datat 19.6.2017, 21.6.2017 dhe 27.6.2017).

Në përgjigje të kërkesës së përsëritur të Komisionerit për të paraqitur dokumentet, ose faktet e ndryshme që zotëronte Ministri në lidhje me shqetësimet e ngritura në mbledhjen e fundit të Task Forcës, anëtarët e Kabinetit të Ministrit, i dorëzuan grupit të inspektimit, disa materiale shkresore, të evidentuara në procesverbalin e mbajtur në datën 21.06.2017, ndërmjet grupit të inspektorëve të Komisionerit dhe dy anëtarëve të Kabinetit të Ministrit.

Në përmbajtjen e këtij procesverbali janë evidentuar 36 materiale shkresore, dokumente të ndryshme, ndër të cilat edhe akte të printuara nga posta elektronike (*e-mail*), në përmbajtjen e të cilave evidentohen disa veprime, e komunikime të realizuara nga Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Kabineti i tij, duke filluar nga data 29.05.2017, deri në datën 20.06.2017.

Për sqarimin e rrethanave dhe të fakteve që kanë të bëjnë me rastin që po analizojmë, do të evidentojmë në mënyrë të detajuar, materialet shkresore të cilat pasqyrojnë veprimet dhe komunikimet e kryera *deri në datën 13.06.2017*, datë në të cilën sipas urdhrit nr. 7/Extra, datë 13.06.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit*”, është vendosur pezullimi nga detyra i Sekretarit të Përgjithshëm të MAS. Paraprakisht, sqarojmë se ky urdhër është konstatuar nga Komisioneri, si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak se Ministri i Arsimit dhe Sportit, ka vepruar në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të ligjit lidhur me kompetencën e organit publik dhe është kërkuar nga Ministri që të rikthejë në detyrë Sekretarin e Përgjithshëm dhe të rregullojë të gjitha pasojat që kanë ardhur nga ky veprim i paligjshëm.

Në lidhje me shqyrtimin e rastit, objekt i kësaj procedure administrative, nga ana e institucionit është vënë në dispozicion të Komisionerit dokumentacioni si më poshtë:

- ✓ Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit (*nuk ka numër protokollit dhe datë por vetëm shënimin “Për njoftim dhe zbatim 02.06.2017”*);
- ✓ Urdhër nr. 311, datë 29.05.2017 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për emërim në detyrë*”;
- ✓ Komunikimet nëpërmjet postës elektronike, midis Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, të printuara në letër (*e-mail-et e datës 1 Qershor 2017, konkretisht i orës 09:13, 10:05, 10:13, 11:58, 14:16, 14:54 dhe të datës 9 Qershor 2017, për komunikimet e orës 13:07*);
- ✓ Memo e datës 13.06.2017, e Sekretarit të përgjithshëm të MAS, me subjekt, “*Mbi urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sport, “Për pezullimin e lejeve vjetore të nëpunësve, punonjësve dhe funksionarëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe të institucioneve të varësisë, për periudhën 02.06.2017-30.06.2017”*”.

Nga shqyrtimi në tërësinë e tyre të rrethanave dhe materialeve të vëna në dispozicion, e sidomos të përmbajtjes së urdhrit “*Për pezullimin e lejeve vjetore të nëpunësve, punonjësve dhe funksionarëve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe të institucioneve të varësisë, për periudhën 02.06.2017-30.06.2017*”, i cili ashtu si e evidentuam edhe më lart, është pa numër protokollit dhe pa datë, por ka vetëm shënimin “*Për njoftim dhe zbatim 02.06.2017*”, rezulton se

është kërkuar nga Ministri që për periudhën 14 – 30 qershor 2017, të pezullohen lejet vjetore për nëpunësit, funksionarët dhe punonjësit e MAS dhe institucioneve të varësisë, si dhe ndërprerjen e lejeve vjetore për nëpunësit që ishin me leje, duke përmendur si shkak të vetëm ngarkesën në punë.

Më tej, konstatohet se, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në konsultim me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, me anë të memos së datës 13.06.2017, ka sqaruar drejtuesin e institucionit, se lejet vjetore të miratuara, tashmë nuk mund të anulohen, duke ju referuar rregullimeve ligjore e nënligjore që disiplinonjë këtë aspekt të punës.

Duke e analizuar këtë moment, nisur nga baza ligjore që e rregullon atë, Komisioneri vlerëson se ky qëndrim i Sekretarit të Përgjithshëm të MAS është i drejtë. Kjo për faktin se leja për pushime vjetore, të paguara, është një e drejtë e nëpunësit civil, e parashikuar në pikën 1, të nenit 40, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar. Më konkretisht, kjo dispozitë parashikon se: *“Nëpunësi civil ka të drejtën për pushime vjetore të paguara, si dhe për pushime të tjera me apo pa pagësë”*.

Ndërkohë, kohëzgjatja e pushimeve, koha e kryerjes së tyre dhe veprimet që duhet të kryjë nëpunësi dhe institucioni në këtë rast, janë të rregulluara me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”*, i ndryshuar.

Në pikën 2, të Kreut II, të këtij akti nënligjor, është parashikuar se: *“Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar është 4 javë kalendarike. Koha e kryerjes së lejes së pushimit vjetor përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, sipas kërkesës së nëpunësit civil, apo të punonjësit duke mos cënuar vijueshmërinë e punës”*.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për një të drejtë të nëpunësit civil, ashtu si është leja vjetore, ku institucioni, për të mos cënuar vijueshmërinë e punës, vetëm planifikon kohën e kryerjes së saj, për çdo nëpunës, e më tej, sipas kërkesës së paraqitur nga nëpunësi, leja miratohet nga eprori përkatës.

Në këto rrethana, një leje e miratuar në mënyrë të rregullt nga ana e organit kompetent, nuk mund të ndërpritet me pretendimin se ka ngarkesë në punë, pa e specifikuar konkretisht arsyen, pasi ngarkesa në punë për një sektor, drejtori apo institucionin në tërësi, verifikohet që në momentin e miratimit të lejes.

Vetëm në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (*gjë e cila nuk provohet që të ketë ndodhur*) do të legjitimohej ndërprerja e lejes vjetore, tashmë të planifikuar e të miratuar në mënyrë të rregullt nga institucioni.

Nga verifikimi i përmbajtjes së urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 311, datë 29.05.2017 *“Për emërim në detyrë”*, i cili është një akt tjetër që pretendohet se nuk është marrë në konsideratë nga Sekretari i Përgjithshëm, rezulton se, në pikën 3 të tij, është përcaktuar: *“Sektori i Financës të kryejë pagesën sipas VKM nr. 187 ...”* dhe në pikën 4, është përcaktuar: *“Ngarkohet Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij urdhri”*.

Më tej, në shënimin e bërë me shkrim dore në akt, *“Për zbatim dhe njohje urdhri nr. 307, 308, 309, 310, 311, 30.05.2017”*, nuk rezulton që Sekretari i Përgjithshëm të jetë ngarkuar për zbatim

min e këtij urdhri. Pra, në kushtet kur, Sekretari i Përgjithshëm nuk është ngarkuar për zbatimin e këtij urdhri, ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për moszbatimin e tij.

Së fundi, në lidhje me komunikimet nëpërmjet postës elektronike, ndërmjet Ministrin të Arsimit dhe Sportit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, të përmendura më sipër, (*komunikimet me e-mail të datës 1 Qershor 2017, të kryera përkatësisht në orën 09:13, 10:05, 10:13, 11:58, 14:16, 14:54 dhe në datën 9 Qershor 2017, është komunikuar në orën 13:07*), rezulton se, në një rast (në datën 1 Qershor 2017), drejtuesi i institucionit i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm “*vendosjen në dispozicion të Kabinetit*”, ndërsa në një rast tjetër drejtuesi i institucionit është shprehur se “*Kabineti i ministrit është plotësuar ...Pengesja e vetme për të mundësuar funksionimin normal të tij, vijon të jetë tek drejtuesit e drejtorive të MAS, të ngarkuar për zbatimin e urdhrave të Ministrin për emërimet përkatëse ...*”. Në këtë rast, drejtuesi i institucionit i bën me dije Sekretarit të Përgjithshëm, një shqetësim lidhur me mosveprimin e drejtorëve të drejtorive të MAS, por nuk rezulton që të ketë pretendime në lidhje me veprimtarinë e Sekretarit të Përgjithshëm.

Përsa i përket komunikimit me e – mail, të datës 9 Qershor 2017, rezulton se, drejtuesi i MAS kërkon: “*të informohem dhe të plotësohen të gjitha detyrimet e përcaktuara në shkresat nr. 3300 dhe nr. 3299, datë 07.06.2017 të Kryeministritë...*”. Këto shkresa nuk janë vënë në dispozicion të Komisionerit, e për pasojë nuk mund të analizojmë lidhjen që ato kanë me veprimtarinë e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, ndërkohë që kërkesa e Ministrin në këtë rast është vetëm për informim. Në kushtet kur, ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” në nenin 82, përcakton se: “*Në procedurat administrative të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për fakatet e përmendura bie mbi këtë palë...*”, rezulton se pala që ka kërkuar verifikimin e rastit, nuk e ka përmbushur këtë detyrim në lidhje me aspektin që trajtuam në këtë paragraf.

Sa më sipër, Komisioneri e ka realizuar vlerësimin e rrethanave të kësaj çështje, duke u mbështetur në materialet shkresore të administruara në datën 21.6.2017 dhe të trajtuara më sipër.

Në përfundim të analizës së materialeve dhe fakteve të administruara në këtë hetim administrativ, vlerësojmë se, në veprimtarinë apo sjelljen e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, nuk gjenden fakte apo rrethana që të përbëjnë shkak për të rekomanduar fillimin e një ecurie disiplinore pranë Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, i cili në rastin e anëtarit të TND-së, kryen funksionin e Komisionit të Disiplinës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e verifikimit të pretendimeve të ngritura nga Ministri i Arsimit dhe Sportit në mbledhjet e Task Forcës, në lidhje me parregullsi në veprimtarinë dhe sjelljen e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, pasi nuk gjenden fakte apo rrethana që të përbëjnë shkak për të rekomanduar fillimin e një ecurie disiplinore pranë Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes, i cili në rastin e anëtarit të TND-së, kryen funksionin e

Komisionit të Disiplinës.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Ministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë, Zëvendëskryeministri, me cilësinë e drejtuesit të Task Forcës, Kuvendi i Shqipërisë dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA